



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.77/16 gusht 2010), dhe në nenin 32 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ nr. 4/14 korrik 2011), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2017, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR FINANCIMIN DHE LLOGARITJEN E FONDIT TË KOMPENSIMIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë mënyrën e financimit, llogaritjes dhe investimin e Fondit të Kompensimit.
2. Kjo rregullore aplikohet për Byronë Kosovare të Sigurimit dhe siguruesit të cilët janë të licencuar për ofrimin e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të cilët sipas legjislacionit në fuqi duhet të jenë anëtarë të Byrosë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë siç përcaktohen në Ligjin Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe/ose siç përcaktohen më poshtë për qëllim të kësaj rregulloreje:
 - a) *Byroja*- nënkupton Byronë Kosovare të Sigurimit.
 - b) *Sigurues*- nënkupton siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të licencuar nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të sigurimeve.
 - c) *Ligji për sigurimin nga autopërgjegjësia*- nënkupton Ligjin Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.
 - d) *BQK*- nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Fondi i Kompensimit

Fondi i Kompensimit është fond i veçantë i cili administrohet nga Byroja dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve në territorin e Republikës së Kosovës, sipas dispozitave të neneve 18, 19, 20 dhe 21 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.

Neni 4

Financimi i Fondit të Kompensimit

1. Fondi i Kompensimit financohet nga:
 - 1.1 kontributet e rregullta të siguruesve të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Siguruesit do të kontribuojnë financiarisht në Fondin e Kompensimit në baza tremujore, në përpjesëtim të drejtë me primet e realizuara (primet bruto të shkruara) nga shitja e sigurimit të autopërgjegjësisë për 3 muajt e kaluar;
 - 1.2 arkëtimet nga rimbursimi në procedurat e regresit;
 - 1.3 kontributet shtesë të siguruesve, kur fondin i parashikuar sipas paragrafit 1.1 të këtij neni rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat;
 - 1.4 rimbursimet nga pronarët e mjeteve motorike të pasiguruara për të cilët Fondi i Kompensimit ka paguar dëmshpërblim;
 - 1.5 të ardhurat nga investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit;
 - 1.6 burimet e tjera, të cilat nuk ndalohen me ligj.
2. Byroja, jo me vonë se 30 nëntori i çdo viti duhet të dorëzojë në BQK planin e biznesit i cili përveç tjerash duhet të përmbajë planin për pagesë të dëmeve sipas dispozitave të neneve 18, 19, 20 dhe 21 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Ky plan, ndahet për secilin sigurues sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe raportohet tek siguruesit, të cilët përfshijnë këtë planifikim në planet e tyre të biznesit.
3. Byroja, konform këtij plani, në baza kuartale njofton siguruesit për pagesën e arritur më së largu 5 ditë pas përfundimit të kuartalit.
4. Siguruesit anëtarë të Byrosë janë të obliguar të financojnë Fondin e Kompensimit në baza tremujore, brenda 15 ditëve nga dita pranimit të njoftimit nga Byroja.
5. Financimi nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet në llogari bankare të përcaktuar me nenin 7, paragrafi 1, të kësaj rregulloreje.
6. Byroja do ta informojë BQK-në, në baza tremujore për përmbushjen e detyrimeve ndaj Fondit të Kompensimit nga çdo sigurues.

7. Nëse siguruesi nuk bën financimin sipas afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni në llogarinë e Fondit të Kompensimit, Byroja do ta njoftojë BQK-në.

Neni 5

Llogaritja e provizioneve të Fondit të Kompensimit nga Byroja

1. Për dëmet që rrjedhin sipas përcaktimeve nga dispozitat e neneve 18, 19, 20 dhe 21 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Byroja në baza vjetore, bën llogaritjen e provizioneve për dëmet e raportuara por jo të paguara (RBNS) dhe shpenzimet për trajtimin e tyre.
2. Për dëmet që rrjedhin sipas përcaktimeve nga dispozitat e nenit 22 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Byroja bën llogaritjen e provizioneve teknike sipas përcaktimeve të Rregullores për Vlerësimin dhe Mbajtjen e Provizioneve Teknike dhe Matematike për Siguruesit Jetë dhe Jojetë.
3. Llogaritjen e provizioneve sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, e bën aktuari i autorizuar i Byrosë në baza vjetore për vitin që pason, dhe pasi të miratohet kjo llogaritje nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Byrosë, e njëjta dërgohet në BQK për miratim jo më vonë se data 30 nëntor e çdo viti.
4. Provizionet për Fondin e Kompensimit sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni duhet të ndahen nga siguruesit, anëtarë të Byrosë dhe si të tilla duhet të pasqyrohen në bilancet e tyre të gjendjes.

Neni 6

Financimi shtesë

1. Në rast se Fondi i Kompensimit i parashikuar për vitin kalendarik rezulton i pamjaftueshëm për të kryer pagesat ose në rastet kur fondet në dispozicion të Fondit të Kompensimit rezultojnë të jenë nën minimumin e kërkuar me nenin 4, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje, me propozim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Byrosë dhe me miratimin e BQK-së, siguruesit duhet të bëjnë financim shtesë të Fondit të Kompensimit.
2. Financimi shtesë i Fondit të Kompensimit llogaritet njësoj siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Mbajtja dhe investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit

1. Byroja do të hapë llogari të veçanta në emër të Fondit të Kompensimit në banka dhe/ose degë të bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja. Ky fond duhet të përdoret vetëm për

qëllime të lejuara me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe këtë rregullore.

2. Fondi i Kompensimit mund të investohet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe depozita bankare me afat maturimi jo më shumë se 1 vit.
3. Investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit në depozita bankare nuk mund të kalojë më shumë se 30% të totalit të mjeteve të investuara në një bankë të vetme ose degë të bankës së huaj.
4. Investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit duhet të bëhet në harmoni me parimet dhe dispozitat e Rregullores për Investimin e Aseteve në Mbulim të Provizioneve Teknike dhe Matematike si dhe Investimin e Kapitalit Themeltar të Siguruesve.
5. Byroja paraqet çdo 3 muaj një raport përmbljedhës në BQK lidhur me gjendjen dhe llojin investimit të mjeteve në mbulim të Fondit të Kompensimit.

Neni 8

Raportimi

1. Byroja është e obliguar të përgatisë raporte dhe llogari tremujore dhe vjetore dhe të raportojë në BQK në harmoni me dispozitat e Rregullores për Standardet e Raportimit dhe të Mbikëqyrjes së Byrosë Kosovare të Sigurimeve dhe rregullativës tjetër në fuqi.
2. Përveç siç përcaktohet me paragrafin 1 të këtij neni, Raportet vjetore të Byrosë duhet të përfshijnë edhe opinionin e aktuarit të autorizuar lidhur me adekuatshmërinë e provizioneve, për dëmet që janë detyrime të Fondit të Kompensimit. Aktuari i Byrosë bën llogaritjen e provizioneve në harmoni me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e Rregullores për Vlerësimin dhe Mbajtjen e Provizioneve Teknike dhe Matematike për Siguruesit Jetë dhe Jo-Jetë", si dhe shpalosë opinionin e tij/saj lidhur me adekuatshmërinë e tyre.

Neni 9

Trajtimi i dëmeve

1. Byroja mund t'ia delegojë trajtimin dhe pagesën e dëmeve që janë detyrime të Fondit të Kompensimit njërit prej anëtarëve të vet ose një strukture të specializuar për trajtimin e dëmeve të licencuar nga BQK-ja, e cila është e detyruar të trajtojë dhe të paguajë dëmin me shpenzimet e Fondit të Kompensimit.
2. Për trajtimin e dëmeve që janë detyrime të Fondit të Kompensimit aplikohen dispozitat e Rregullores mbi Procedurat e Trajtimit të Kërkesave për Kompensimin e Dëmeve që Rrjedhin nga Sigurimi i Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe Rregullores për Përcaktimin e Kritereve për Vlerësimin e Dëmeve Jomateriale nga Autopërgjegjësia.

3. Byroja me rregullore mund të përcaktojë procedurat e delegimit të trajtimit dhe pagesës së dëmeve që janë detyrime të Fondit të Kompensimit.

Neni 10

Përfundimi i vitit financiar të Fondit të Kompensimit

1. Për çdo periudhe tremujore financiare hartohet bilanci i gjendjes së Fondit të Kompensimit dhe pasqyra e kontributeve dhe pagesave të tij.
2. Në fund të çdo periudhe tremujore financiare, Fondi i Kompensimit duhet të mbyllet teorikisht. Tepricat nga kontributet në llogaritë e Fondit të Kompensimit në këto data mbyllëse të çdo tremujori, do të pasqyrohen në bilancin e Byrosë si detyrime financiare ndaj siguruesve në raport me përqindjet që ata kanë kontribuar në Fondin e Kompensimit për periudhën në fjalë. Në fillim të periudhës financiare pasuese, Byroja do t'i njohë në bilanc këto detyrime si pjesë të kontributit të siguruesve në Fondin e Kompensimit për periudhën vijuese, e llogaritur kjo në raport me përqindjen e kontributit që i përket çdo siguruesi për periudhën vijuese financiare.

Neni 11

Masat Ndëshkimore

1. Në rast se siguruesit nuk zbatojnë detyrimet e parashikuara në këtë rregullore, Byroja njofton BQK-në për moszbatimin e detyrimeve, dhe BQK-ja mund të shqiptojë masat ndëshkuese, si në vijim:
 - a. *“shqipton gjobë, nga dhjetëmijë (10.000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro ndaj siguruesit kur siguruesi nuk paguan kontribute të përcaktuara për fondin e kompensimit sipas nenit 37, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia”.*
 - b. *“ndalon lëshimin e policave të reja të sigurimit apo ndalon përtëritjen e policave ekzistuese”* për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, sipas nenit 124, nënparagrafi 2.3, të Ligjit për Sigurimet.
 - c. *“kur siguruesi nuk ka zbatuar detyrimet e parashikuara në këtë ligj për financimin e fondeve, BQK-ja i revokon siguruesit licencën për veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm”* sipas nenit 32, paragrafi 11, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.
2. Në rast se nga personat përgjegjës të Byrosë nuk zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje, BQK-ja do të shqiptojë masa ndëshkuese sipas përcaktimeve të nenit 38 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Neni 12

Shfuqizimi

1. Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Fondin e Kompensimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur me datë 27 korrik 2012.

2. Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet neni 6 i Rregullores për Standardet e Raportimit dhe të Mbikëqyrjes së Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe neni 6, paragrafi 11, i Rregullores për Vlerësimin dhe Mbajtjen e Provizioneve Teknike dhe Matematike për Siguruesit Jetë dhe Jo-Jetë.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 31 dhjetor 2017.

Prof. Dr. Bedri Peci
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore